



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Nr. 7.18/2 Prot.

Pukë, më 29 / 04 / 2026

**Lënda:** Kërkesë për pranim projekt-vendimi në rendin e ditës.

Drejtuar: Kryetarit të Këshillit të Bashkisë, Pukë

Z. Gjon GJOKA

Z. Kryetar i Këshillit të Bashkisë Pukë!

Në zbatim të rregullores së funksionimit të Këshillit të Bashkisë Pukë, kërkoj mirëkuptimin tuaj për pranimin në rendin e ditës të mbledhjes së dates 30.04.2026 të projektvendimit nr. 08, datë 29.04.2026;

**“Për një shtesë në VKB nr.48, datë 19.12.2025” “Për trajtimin me bursë të nxënësve të shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025-2026.”**

*Faleminderit për mirëkuptimin tuaj!*

**KRYETARI**

**Rrok DODAJ**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Nr. 718 prot.

Pukë, më 29/04 2026

PROJEKT - VENDIM

Nr. 0 datë 29/04/2026

PËR NJE SHTESE NE VENDIMIN NR.48 DATE 19.12.2025

PER

**“ TRAJTIMIN ME BURSË TË NXËNËSVE TE SHKOLLAVE TE MESME PROFESIONALE  
PËR VITIN SHKOLLOR 2025—2026”**

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”; VKM- së 511, datë 27/07/2022, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 666,date 10.10.2019, “ Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit para universitare në institucionet arsimore publike”, shkresës me nr.973/1 prot,date 29/10/2025 të Ministrisë së Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit, me subjekt “Planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit para universitare në institucionet arsimore publike”, që ndjekin vitin e pare në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2025 - 2026, sipas kërkeses per trajtim te vecante drejtuar Ministrise se Ekonomise me shkrese nr. 297 prot, date 19.02.2026 si dhe miratimin e kërkeses nga ana e Ministrise me shkresen nr. 1636/1 date 24,04.2026 , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli:

VENDOSI:

1.Të trajtohet me burse të plotë bazuar në VKM- së 511, datë 27/07/2022, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 666,date 10.10.2019 “ Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2025–2026”, nxënësit që ndjekin mësimin në vitet e para të shkollave të mesme të arsimit profesional, si më poshtë;

Nr	Emer Ateshi Mbiemer	Shkolla	Qyteti	Dega	V/banimi	Niveli I burses	Kriteret e perfit VKM -së 511, datë 27/07/2022
1	Klodiana Firrok Ndoci	Shkolla Profesionale " Shen Jozeff"	Rreshen	Sherbime sociale dhe shendetsore	Gjegjan	Plote	Pika 2)2.1 germa a

2. Ky vendim të bëhet publik në faqen zyrtare të institucionit për nxënësit, komunitetin, median dhe institucionet e tjera.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sektori i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit 55, pika 6 të ligjit nr. 139/2015

**Drejtor i Burimeve Njerëzore**

Sokol Gjoni



**Jurist**

Aida Sinani



**KRYETARI**

Rrok Dodaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 718/prot.

Pukë, më 29.042026

Relacion

**“PËR TRAJTIMIN ME BURSË TË NXËNËSES SE SHKOLLES SE MESME  
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2025-2026”**

Në mbështetje dhe në zbatim të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”; VKM- së 511, datë 27/07/2022, “Per disa ndryshime dhe shtesa ne Vendimin nr. 666,date 10.10.2019, “ Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit para universitare në institucionet arsimore publike”, shkresës me nr.973/1 prot,date 29/10/2025 të Ministrisë së Ekonomisë, Kultures dhe Inovacionit, me subjekt “Planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit para universitare në institucionet arsimore publike”, që ndjekin vitin e pare në shkollat e mesme të arsimit profesional për vitin mësimor 2025 - 2026, sipas kërkeses per trajtim te vecante drejtuar Ministrise se Ekonomie me shkrese nr. 297 prot, date 19.02.2026 si dhe miratimin e kërkeses nga ana e Ministrise me shkresen nr. 1636/1 date 24,04.2026 , me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli:

1. Pas paraqitjes se dokumentacionit dhe verifikimit sipas parashikimeve ligjore, kerkojme nga ana juaj miratimin e tyre me burse, sic eshte paraqitur ne projekt-vendim.

Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore

Sokol Gjoni

28.04.26

S. Gary  
20/04/2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT  
DREJTORIA E PËRGJTHSHME E POLITIKAVE TË PUNËSIMIT, AFTËSIMIT  
DHE SIGURIMEVE SHOQËRORE

Nr. 1636 / Prot. 11

Tiranë, më 24 / 04 / 2026

U R D H Ë R

Nr. 207, Datë 24.04 2026

PËR  
MIRATIMIN E SHTYRJES SË AFATIT TË MARRJES SË VENDIMIT PËR BURSAT E  
NXËNËSVE TË KLASAVE TË 10-TA TË ARSIMIT PROFESIONAL, NË KËSHILLIN  
BASHKIAK ELBASAN DHE PUKE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të pikës 33 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar, si dhe shkresës nr. 1237 Prot., datë 05.03.2026, të Bashkisë Elbasan dhe shkresës nr 297 datë 19.02.2026 të bashkisë Pukë.

URDHËROJ:

1. Miratimin e shtyrjes së afatit për marrjen e vendimit nga Këshilli Bashkiak Elbasan për bursat e nxënësve të arsimit profesional (të cilët kanë paraqitur dokumentacionin me vonesë) që ndjekin shkollat e mesme profesionale publike, deri më datë 30 prill 2026.
2. Miratimin e shtyrjes së afatit për marrjen e vendimit nga Këshilli Bashkiak Pukë për bursat e nxënësve të klasave të 10-ta, të arsimit profesional (të cilët kanë paraqitur dokumentacionin me vonesë) që ndjekin shkollat e mesme profesionale publike, deri më datë 30 prill 2026.
3. Vendimmarrja e Këshillit Bashkiak Elbasan dhe Këshillit Bashkiak Pukë, duhet të respektojë numrin e bursave të miratuara për Bashkinë Mallakastër sipas shkresës së Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 973/1, datë 29.10.2025, “Dërgohet plani i shpërndarjes së bursave për nxënësit që ndjekin klasën e 10-të në shkollat e mesme të arsimit profesional publik, për vitin shkollor 2025–2026”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Delina Ibrahimaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA PUKË  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 297 prot.

Pukë, më 19.07.2026

**Lënda:** Kërkesë për trajtim të veçantë sipas pikës 33 të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, i ndryshuar

**Drejtuar:** MINISTRISË SË EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT

E nderuar Zj. Ministër,

Në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar...”, i ndryshuar, konkretisht **pikës 33**, ku citohet:

*“Vendimet e këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore, në raste të veçanta, mund të miratohen përtej këtij afati me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin parauniversitar apo për arsimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse.”*

Ju parashtrojmë sa vijon:

Nxënësja **Klodiana Ndoci**, aktualisht në klasën XI, në degën “Shërbime Social-Shëndetësore”, pranë shkollës profesionale Shkolla Profesionale "Shën Jozefi Punëtor", ka paraqitur kërkesën për trajtim me bursë, duke depozituar dokumentacionin përkatës pas përfundimit të procedurës së vendimmarrjes nga Këshilli Bashkiak.

Bashkia Pukë me Vendimin nr. 48, datë 19.12.2025, ka miratuar listën e përfituesve të bursave për nxënësit e shkollave të mesme profesionale për vitin shkollor 2025–2026. Megjithatë, dokumentacioni i nxënëses në fjalë është depozituar me vonesë, për shkaqe objektive që lidhen me ndryshimin e statusit juridik të institucionit arsimor, i cili nga shkollë private është kthyer, me vendim përkatës, në shkollë shtetërore profesionale.

Kjo situatë ka sjellë vonesa në depozitimin e dokumentacionit përkatës nga ana e nxënëses dhe familjes së saj, duke bërë që aplikimi të mos shqyrtohej brenda afatit mujor të përcaktuar në pikën 32 të VKM-së.

Duke qenë se rasti në fjalë përbën një **rast të veçantë**, në kuptim të pikës 33 të VKM-së së sipërcituar, dhe duke konsideruar parimin e barazisë në trajtimin e nxënësve që ndjekin arsimin profesional publik, kërkojmë nga ana Juaj shqyrtimin dhe miratimin e këtij rasti përtej afatit, me urdhër Tuaj, në mënyrë që nxënësja Klodiana Ndoci të përfshihet në skemën e përfitimit të bursës për vitin shkollor 2025–2026.

Vlerësojmë se plotësohen kushtet ligjore dhe fryma e vendimit për të garantuar mbështetje për nxënësit e arsimit profesional, veçanërisht në situata tranzitore institucionale si rasti konkret.

Në pritje të një përgjigjeje nga ana Juaj për ecurinë e mëtejshme procedurale,

Me respekt,

**KRYETARI**

Rrok Dodaj

